



**PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË
KOSOVËS**

Pasqyrat Financiare Vjetoredhe Raporti i Auditorëve të pavarur

01 Janar 2016 - 31 Dhjetor 2016

Përmbajtja

| | |
|---|----------|
| Raport i Auditorëve të pavarur | 3 |
| Pasqyra e Pozitës Financiare | 7 |
| Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve | 8 |
| Informata të përgjithshme | 9 |

Raport i Auditorëve të pavarur

Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i opinionit

Ne kemi audituar të bashkëngjitur Pasqyrat Financiare të Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “PDAK”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2016, dhe Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq. 7-11.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të subjektit **Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës**. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të patur një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për mohim të Opinioneve

- Subjekti politik nuk ka dorëzuar shënime mbi asetet, detyrimet dhe ekuitetin e SP me 31 Dhjetor 2016 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar. Në mungesë të dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse asetet, detyrimet dhe ekuiteti i deklaruar pasqyrojnë drejt gjendjen SP me 31 Dhjetor 2016. Për më tepër pasuritë dhe burimet e financimit nuk janë të balancuara në pasqyrën e pozitës financiare me 31 Dhjetor 2016 dhe 2015.
- SP ka paguar paga dhe kompenzime në vlerë prej 12,140 Euro, por që nuk janë përlllogaritur dhe deklaruar tatimet dhe kontributet si tatim në burim bazuar në Ligjin Nr.05/L-28 për Tatimin në të Ardhura Personale sipas kërkesës nga neni 7 i ligjit.
- Subjekti politik nuk ka dorëzuar në KQZ kopjet e faturave mbi shpenzimet e raportuara si të transportit në vlerë prej 9,533 Euro si dhe shpenzimet e përgjithshme në vlerë prej 5,151 Euro ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar. Në mungesë të dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse shpenzimet e raportuara janë të sakta dhe prezantojnë drejt aktivitetin e SP.

- Subjekti Politik nuk ka prezantuar të hyra nga kontributet në natyrë në mall dhe shërbime, në mungese të dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse SP ka pranuar apo jo kontributet në natyrë në mall dhe shërbime.
- Subjekti Politik nuk ka prezantuar pagesat e kryera në vlerë mbi 5,000 EUR një marrësi të vetëm, ne mungese të dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse SP ka kryer pagesa në vlerë mbi 5,000.00 EUR një marrësi të vetëm.
- Në mungese të konfirmimeve nga bankat ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse SP ka vetëm një llogari bankare ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 11, paragrafi 3.

Theksim i çështjes

Pa dashur ta ndryshojm opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për të mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve të kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit drejtues ose përgjegjësit financiar për transaksionet financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për

Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpалosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të

këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit

të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Agron Mustafa
Auditor Ligjor
29 Nëntor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

| Pasuritë | | Me 31 Dhjetor 2016 | Me 31 Dhjetor 2015 |
|--|---------|---------------------------|---------------------------|
| Pasuritë afatgjata | Shënimi | Shuma në Euro | Shuma në Euro |
| Toka, objektet dhe pajisjet | | - | - |
| Pasuritë e paprekshme | | - | - |
| Pasuritë tjera afatgjata | | - | - |
| Total pasuritë afatgjata | | - | - |
| Pasuritë afatshkurtra | | | |
| Llogaritë e arkëtueshme | | - | - |
| Parapagimet | | - | - |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë | | - | - |
| Pasuritë tjera afatshkurtra | | - | - |
| Total pasuritë afatshkurtra | | - | - |
| Total pasuritë | | 0.00 | 0.00 |
| Ekuiteti | | | |
| Fondet e akumuluar | | 20 | - |
| Suficiti / (deficiti) i vitit | | 100 | 20 |
| Total Ekuiteti | | 120 | 20 |
| Detyrimet | | | |
| Detyrimet afatgjata | | | |
| Huatë e pagueshme | | - | - |
| Të hyrat e shtyera | | - | - |
| Gjithsej detyrimet agatgjata | | - | - |
| Detyrimet afatshkurtra | | | |
| Llogaritë e pagueshme dhe të tjera | | - | - |
| Huatë e pagueshme | | - | - |
| Detyrimet tjera afatshkurtra | | - | - |
| Gjithsej detyrimet afatshkurtra | | - | - |
| Gjithsej detyrimet | | - | - |
| Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet | | 120 | 20 |

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

| | Shënimi | Viti që përfundon me 31 Dhjetor | |
|--|---------|---------------------------------|---------------|
| | | 2016 | 2015 |
| Të hyrat | | | |
| Të hyrat nga buxheti | | 31,500 | 31,500 |
| Të hyrat nga anëtarësia | | - | - |
| Donacionet dhe kontributet në të holla | | - | - |
| Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime | | - | - |
| Të hyrat e fushatës | | - | - |
| Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera | | - | - |
| Të hyrat tjera | | - | - |
| Gjithsej të hyrat për vitin | | 31,500 | 31,500 |
| | | | |
| Shpenzimet | | | |
| Pagat dhe kompenzimet | 2 | 12,140 | 18,150 |
| Shpenzimet e transportit | 2 | 9,533 | 2,935 |
| Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat | 2 | 3,923 | - |
| Shpenzimet e fushatës | 2 | - | - |
| Blerja e mallrave | 2 | 510 | 54 |
| Shpenzimet e përgjithshme | 2 | 5,151 | 7,214 |
| Shpenzimet e ndryshme | 2 | 144 | 3,125 |
| Gjithsej shpenzimet për vitin | | 31,400 | 31,478 |
| | | | |
| Suficiti / (deficiti) për vitin | | 100 | 22 |

Informata të përgjithshme

Emri i plotë i subjektit është Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (si më tej SP “PDAK”) me seli në Adresën: Rruga ”Vudrov Wilson”, pn Ferizaj.

Pasqyrat financiare të SP PDAK janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar

Subjekti politik është person juridik jo fitimprurës me NF 600535845.

Burimet financiare dhe materiale të subjekteve politike përbëhen nga kontributet si:

1. Financimi nga Buxheti i Republikës së Kosovës;
2. çdo pasuri e fituar në mënyrë të paraparë me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike (më tej si “PDAK”);
3. Të ardhurat nga aktivitetet e subjektit politik të përcaktuara me nenin 6 të ligjit LFSP.

Qëllimi i përdorimit të mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike

1. Mjetet nga Fondi mund të përdoren për këto qëllime:

- 1.1. Financimi i aktiviteteve të subjekteve politike;
- 1.2. Financimi i degëve të subjekteve politike;
- 1.3. Për shpenzime materiale vjetore të deputetëve dhe punën e Grupeve Parlamentare për aktivitete partiake;
- 1.4. Për shpenzime për zgjedhjet lokale dhe qendrore, dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme të subjekteve politike.

Shënimi 2: Shpenzimet

| | Shpenzimi | Pagesa | Borxhi i mbetur |
|--|------------------|----------------------|------------------------|
| Shpenzimet | në Euro | në Euro | në Euro |
| Pagat dhe kompenzimet | | | |
| Pagat dhe kompenzimet, neto | 12,140 | 12,140 | - |
| Kontributet pensionale të punëmarrësit | - | - | - |
| Kontributet pensionale të punëdhënësit | - | - | - |
| Tatimet në të ardhura personale | - | - | - |
| Beneficionet tjera | - | - | - |
| Gjithsej | 12,140 | 12,140 | - |
| Shpenzimet e transportit | | | |
| Automjetet motorike të huazuara | - | - | - |
| Karburantet | 3,045 | 3,045 | - |
| Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj. | - | - | - |
| Sigurimi dhe mirëmbatja e veturave | - | - | - |
| Çdo shpenzim tjetër i transportit | 6,488 | 6,488 | - |
| Gjithsej shpenzimet e transportit | 9,533 | 9,533 | - |
| Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat | | | |
| Lokali | - | - | - |
| Ushqimi | 3,923 | 3,923 | - |
| Aktivitete kulturore dhe rekreative | - | - | - |
| Radio dhe spotet televizive | - | - | - |
| Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta | - | - | - |
| Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave | - | - | - |
| Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat | 3,923 | 3,923 | - |
| Shpenzimet e fushatës | | | |
| Shpenzimet e fushatës | 0 | 0 | - |
| Gjithsej shpenzimet e fushatës | 0 | 0 | - |
| Blerja e mallrave | | | |
| Furnizimi i zyrës | 70 | 70 | - |
| Pajisjet të vogla | 440 | 440 | - |
| Gjithsej blerja e mallrave | 510 | 510 | - |
| Shpenzimet e përgjithshme | | | |
| Qiraja e lokalit të zyrës | 4,330 | 4,330 | - |
| Telefoni, interneti dhe posta | 736 | 736 | - |
| Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat) | 85 | 85 | - |
| Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë | 0 | //////////////////// | |
| Shpenzimet lidhur me donacionet dhe | 0 | //////////////////// | |

Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2016 deri më 31 Dhjetor, 2016

| | | | |
|---|---------------|---------------|----------|
| kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime | | | |
| Gjithsej shpenzimet e përgjithshme | 5,151 | 5,151 | - |
| Shpenzimet e ndryshme | | | |
| Miëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës | - | - | - |
| Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër | 144 | 144 | - |
| Gjithsej shpenzimet e ndryshme | 144 | 144 | - |
| Gjithsej shpenzimet | | | |
| | 31,400 | 31,400 | 0 |